



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

FAKULTETI I FILOLOGJISË

| PROGRAMI MËSIMOR – SYLLABUS | | | | | | |
|--|---|-------------------------|---------------------------------|---|-----------|-------------------|
| Niveli i studimeve | Bachelor | Programi | Gjuhë dhe letërsi shqipe | Viti akademik | 2019-20 | |
| LËNDA | Letërsi moderne shqipe I | | | | | |
| Viti | i parë | Statusi i lëndës | Obligative | Kodi | | ECTS kredi |
| Semestri | i pestë | | | | | 6 |
| Javët mësimore | 15 (pesëmbëdhjetë) | | | Orët mësimore | Ligjërata | |
| | | | | 3+2 | | |
| Metodologjia e mëimit dhe përshkrimi i lëndës | Ky kurs u mundëson studentëve njohjen me letërsinë moderne shqipe, pra deceniet e para të shekullit XX, duke përfshirë këtu njohjen e rrymave, individualizimin krijues të këtyre përfaqësuesve në letërsinë shqipe, shfaqjen dhe konsolidimin e të gjitha formave letrare, si dhe kahjet e mendimit teorik-kritik për problemet e letërsisë, por edhe të kulturës nacionale në përgjithësi. Përveç kësaj, studentët do të pajisen me dije dhe shkathtësi, që t'ua mundësojë atyre hulumtimin, analizimin e studimin e pavarur të teksteve letrare. | | | | | |
| Konsultime | | | | | | |
| Mësimdhënësi | Prof.ass.dr. Teuta Vinca- Kafexholli | | e-mail | teuta.kafexholli@uni-prizren .com | | |
| | | | Tel. | 045- 405 444 | | |
| Asistenti | Xxx | | e-mail | | | |
| | | | Tel. | | | |

| Qëllimi studimor i lëndës | Përfitimet e studentit |
|---|--|
| <p>Qëllimi i kursit Letërsia paramoderne është:</p> <ul style="list-style-type: none"> Njohja e letërsisë moderne shqipe dhe aftësimi për njohjen e konteksteve që kanë ekzistuar në kulturën shqipe në deceniet e para të shekullit XX. Përvetësimi i diturisë së përgjithshme ndaj krijimeve letrare në letërsinë shqipe që nga fillimi i shekullit XX me veprat më të njohura letrare dhe përfaqësuesit më të denjtë të kësaj periudhe. | <p>Studentët do të jenë në gjendje të fitojnë njohuri:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të njoh autorët dhe format e periudhës përkatëse. Të njohë konceptet substanciale të zhvillimit të letërsisë, kryesisht në letërsinë shqipe. Të njohë dhe dallojë format e strukturat letrare – prozë, poezi, dramë – në kuadër të shfaqjes dhe konsolidimit të tyre, si dhe rrymat e mendimit teorik e kritik për letërsinë dhe kulturën shqipe në përgjithësi. |

| | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> Aftësimi për debatimin e vlerave letrare. | <ul style="list-style-type: none"> Të arrijë të hartojë dhe zhvillojë analiza, interpretime, studime të pavaura për letërsinë, tekstet dhe autorët e veçantë në kuadër të lëndës, por edhe jashtë saj. Ta plotësojë korpusin e njohjes dhe studimit të letërsisë nacionale dhe ta shtojë kreativitetin hulumtues në fushën e shkencave humane në përgjithësi. |
|---|---|

| | | | | |
|---|-----------------------|---------------------------|--|----------|
| Metodologjia për realizimin e temave mësimore: | | | | |
| Ligjëratat do të organizohen në modele ndërvepruese apo të kombinuara si: shpjegim – sqarim, ushtrime, analiza tekstore e shkencore, diskutime, punë në grupe, demonstrime dhe interpretime, shtruarje e shqyrtime idesh, hartime krijuese e vetëhulumtuese etj. Këto do të jenë pjesë kryesore për punën e vlerësimit dhe mënyrën apo metodologjinë e të ligjëruarit. | | | | |
| Kushtet për realizimin e temës mësimore: | | | | |
| Varësisht nga tema mund të organizohen dhe realizohen përmes komunikimit interaktiv, ligjërata në modelin klasik, përmes (kompjuterit dhe projektorit) etj. | | | | |
| Mënyra e vlerësimit të studentit (në%) | | | | |
| <p>Vlerësimi do të bëhet duke u mbështetur në, vlerësimet me shkrim (dy teste gjatë vitit akademik), seminare, detyra të shtëpisë, angazhime në klasë dhe në testin përfundimtar.</p> <p>Pikët e vlerësimit:</p> <p>Testi i parë: 15 pikë Testi i dytë: 15 pikë Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 20 pikë Punim seminari 10 pikë Vlerësimi i fundit testi përfundimtar 40 pikë. Totali: 100 pikë</p> | Vlerësimi në % | Nota përfundimtare | | |
| | | | <p>Vlerat e pikëve:</p> <p>51-60 = 6 61-70 = 7 71-80 = 8 81-90 = 9 91-100 = 10 Studentët me rezultat të përgjithshëm nën 50 pikë nuk mbërrijnë notën kaluese.</p> | |
| <p>Obbligimet e studentit: Të jenë pjesëmarrës aktiv, te punoje seminarët; prezantimet dhe hulumtimet e pavarura. Gjatë ligjëratave nuk u lejonet komunikimi me telefon apo modele të tjera të cilat pengojnë procesin e mësimin. Gjatë organizimit të testeve nuk lejonet kopjimi, komunikimi apo ardhja më vonë, sepse do të pengojnë procesin e organizimit të testit.</p> <p>Testet apo provimet organizohen sipas plan-programit të paraparë dhe zgjatë një orë mësimore.</p> | | | | |
| Ligjërata | | Ushtrime | | |
| Në ligjërata studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktiv, të kompletuar dhe të përgatitur me pajisje mësimore, dhe studimore për ta kuptuar dhe realizuar temën e dëgjuar apo plan-programin e lëndës. | | / | | |
| Ngarkesa e studentit për lëndën | | | | |
| Aktiviteti | Orë | Ditë/Javë | | Gjithsej |
| Ligjërata | | 3 | 15 | 45 |
| Kontakte me mësimdhënësin/konsultime | | 1 | 15 | 15 |

| | | | |
|--|---|----|----|
| Seminare, teste, kolokfiume etj. | 4 | 2 | 8 |
| Detyra të shtëpisë | 2 | 4 | 8 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 4 | 15 | 60 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 3 | 1 | 3 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, në provim final) | 4 | 2 | 8 |
| Projekte, prezantimet etj. | 1 | 3 | 3 |

| | | |
|---|------------------|-----|
| Vërejtje: 1 ECTS kredi=25 orë angazhim,p.sh nëse lënda i ka 6 ECTS kredi student duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë | Ngarkesa totale: | 150 |
|---|------------------|-----|

| Java | Ligjërata | Orët |
|------|---|------|
| 1. | Vështrim i përgjithshëm historik dhe letrar i gjysmës së parë të shekullit XX. Letërsia paramoderne shqipe <ul style="list-style-type: none"> • Poetët e periudhës kalimtare (Çajupi, Mjeda, Asdreni) • Modernja dhe modernizmi • Orijentimet kryesore dhe strukturat letrare | 3 |
| 2. | Letërsia pasromantike <ul style="list-style-type: none"> • Poet i periudhës kalimtare • Autorë të tjerë të fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX • F. Shiroka, L.Gurakuqi. • H, Mosi, R. Siliqi. • Thoma Kacori. | 3 |
| 3. | Andon Zako Çajupi <ul style="list-style-type: none"> • Çajupi dhe krijimtaria letrare pasromantike dhe paramoderne • Jeta dhe pikëpamjet • “Baba Tomorri” • “Baba Musa lakuriq” • “Pas vdekjes” | 3 |
| 4. | Aleks Stavre Drenova- Asdreni <ul style="list-style-type: none"> • Poet që u përket njëherësh dy periudhave letrare • Pararendës i poezisë moderne shqiptare • Lirika patriotike dhe shoqërore • Lirike intime • “Rreze dielli”, “Ëndrra e lot”, “Psallme murgu” | 3 |
| 5 | Ndre Mjeda <ul style="list-style-type: none"> • Poet paramodern • “Andrra e jetës” • Tingëllimat: “Liria”, “Lissus”, “Scodra” | 3 |

| | | | |
|-----|--|---|--|
| 6. | Gjergj Fishta <ul style="list-style-type: none"> • Epi “Lahuta e malcis” • Dramatika e Fishtës: struktura e ligjërimit dramatik • “Juda Makabe” | 3 | |
| 7. | Gjergj Fishta <ul style="list-style-type: none"> • Poezitë satirike në veprat poetike “Anzat e Parnasit”, “Gomari i Babatasit” • “Mrizi i Zanavit”, motivi atdhetar • “Vallja e Parrizit”, analizë | 3 | |
| 8. | Provimi i parë intermediar | 3 | |
| 9. | Faik Konica <ul style="list-style-type: none"> • Mjeshtëri i fjalës shqipe • Romani Dr. Gjilpëra” • “Kopshti shkëmbor” • “Kritika letrare” • Esejistika” | 3 | |
| 10. | Mid`hat Frashëri <ul style="list-style-type: none"> • Vepra kritike • “Hi dhe shpuzë”- vepër me prozë • Prozat poetike • Novelat • “Plagët tona” | 3 | |
| 11. | Fan Noli <ul style="list-style-type: none"> • Autobiografia • Mërgimi politik • Poezia e Nolit • “Israelitë dhe Filistinë” | 3 | |
| 12. | Ali Asllani <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria dhe krijimtaria • Poeti me humor, poezia e dashurisë, patriotike, sociale. • Ndikimi i poezisë popullore në poezinë e Ali Asllani • “Hanko Halla”, poemë humoristike | 3 | |
| 13. | Kristo Floqi <ul style="list-style-type: none"> • Kontributi dhe vendi që zë në letërsinë tonë në periudhën 1912-39. • Krijimtariaja dramaturgjike • Komedia dhe farsa | 3 | |
| 14. | Grup shkrimtarësh të tjerë me trajta neoklasiciste dhe me frymë sentimentale <ul style="list-style-type: none"> • Foqion Postoli; Milto Sotir Gurra, Anton Harapi; • Vedat Kokona; Dhimitër Shuteriqi; Shefqet Musaraj; • Lame Kodra; Nexhat Hakiu; Gaspër Pali; • Arshi Pipa; Esad Mekuli; Mustafa Greblleshi; Qemal Draqini | | |
| 15. | Provimi i dytë intermediar | 3 | |

LITERATURA BAZË

Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqipe*, Shtëpia Botuese Universitare "UET Press", Tiranë, prill, 2013.

Grup autorësh: *Historia e letërsisë shqiptare*, "Rilindja", Prishtinë, 1989.

Robert Elsie: *Historia e letërsisë shqiptare*, "Dukagjini", Pejë, 2011.

Rexhep Qosja: *Asdreni- Jeta dhe vepra*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1972.

Rexhep Qosja, *Prej letërsisë romantike deri te letërsia moderne*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010.

LITERATURA SHITESË

Eqrem Çabej, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, në "Studime gjuhësore", vëllimi V, "Rilindja", Prishtinë, 1988.

Grup autorësh: Gjergj Fishta

Sali Bashota, *Proza e filleve të modernitetit*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2006.

Mendimtarë shqiptarë, *Plagët tona*, DiJa, Prishtinë, 2000.